

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E SUPERINTENDENTIT
440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

6 Mars 2018

Të dashur Prindër dhe Kujdestarë:

Nën dritën e tragjedisë së fundit të ndodhur në vrasjet me armë në një shkollë në Florida, nxënësit në të gjithë vendin, janë në kërkim të gjetjes së rrugëve për kapërcimin e pasojave të kësaj ngjarje të tmerrëshme. Si rezultatit i kësaj, në datën 14 Mars nxënës nga i gjithë vendi kanë planifikuar të marshojnë jashtë shkollave për 17 minuta, në solidarizim me nxënësit e Floridës, duke bërë thirrje për përmirësimin e ligjeve të armëmbajtjes dhe që të sjellin shqetësimin dhe vetëditësimin për dhunën nga armët në komunitetet dhe shkollat tona.

Në solidaritet me këtë lëvizje kombëtare, nxënësve që kanë zgjedhur të manifestojnë, do t'ju mundësohet grumbullimi në vendet e përcaktuara, që të gjithë manifestuesit të mblidhen në një mënyrë të organizuar dhe të sigurtë. Sidoqoftë, shkollat në këtë rast as nuk do të nxisin dhe as nuk do t'i pengojnë nxënësit për manifestim, si edhe nuk do jenë pengesë në këto manifestime duke ndërmarrë masa disiplinore ndaj nxënësve pjesëmarrës. Veprimtaritë e rregullta shkollore do të vazhdojnë normalisht gjatë manifestimit dhe nxënësit pjesëmarrës pritet që t'i bashkohen këtyre veprimtarive pas përfundimit të manifestimit.

Ne e kemi të qartë që ka qasje të ndryshme se si duhet të reagojë kombi ndaj kësaj tragjedie të fundit dhe se mund të ketë nxënës, të cilët nuk do të duan të marrin pjesë në këto manifestime dhe preferojnë të qëndrojnë në klasë. Ne duam t'i sigurojnë nxënësit dhe familjet tona, që do të bëjmë gjithëçka që të gjithë nxënësit të ndjehen të sigurtë dhe të respektuar, pavarësisht zgjedhjeve të tyre. Si gjithmonë, siguria e nxënësve tanë është përparësia jonë kryesore.

Si drejtori arsimore ne i nxitim nxënësit tanë që të jenë qytetarë aktivë dhe njohës të ngjarjeve . Kjo mund të jetë një mundësi e cila i ndihmon nxënësit tanë të aplikojnë mësimet që kanë mësuar në shkollë. Mbi të gjitha, ne dëshirojmë që ata të dinë se ne e vlerësojmë zërin e tyre dhe të drejtën e tyre për t'u vetëshprehur. Si përfundim, ne kemi vënë në dispozicion gjithë burimet tona për drejtuesit e shkollave, që të organizojnë aktivitete shkollore dhe/ose aktivitete të cilat i lejonë nxënësit të shprehin mendimet dhe idetë e tyre, që e plotësojnë manifestimin, ose një tjetër alternativë, ndërsa garantojnë sigurinë e tyre.

Ky incident nënvizon nevojën që të gjithë ne si komunitet i shkollës, të punojnë bashkërisht për sigurinë e shkollave dhe komunitetieve tona. Ju lutemi gjeni kohën e duhur të flisni me fëmijën tuaj për pasojat serioze të sjelljes në shkollë të çfarëdolloj arme. Është e rëndësishme që fëmija të dijë se, kur ka nevojë për ndihmë ose ka shqetësim për sigurinë e tij, të drejtohet menjëherë te personeli i shkollës, ose polici. Mbështetja e fëmijëve tanë me biseda të hapura dhe pozitive është thelbësore për t'a, që të dijnë ku të drejtohen nëse ndodhen në situata të pasigurisë.

Ju lutemi mbani në dijeni, që nëse fëmija juaj sheh diçka, ahëre thuaj diçka! Ka dy rrugë për raportim:
Telefononi: 215-400-SAFE ose Email: ask@philasd.org

Ne do të vazhdojmë të krijojmë mjedisin mësimor më të sigurtë dhe pozitiv të mundshëm për fëmijët tuaj.

Sinqerisht,



William R. Hite, Jr., Ed.D.